



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2024:063093

Datë: 15.03.2024

Numri i dokumentit: 05455811

P.nr.65/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Minir Hoti me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fatmire Podvorica, dhe bashkëpunëtorit profesional Izet Hyseni, në çështjen penale kundër të akuzuarit: A. R., për shkak të veprës penale Falsifikimi i dokumentit nga neni 390 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.3693/2022 të dt.22.02.2024, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur më dt. 13.03.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit – Menduhi Kastrati, dhe të akuzuarit, në të njëjtën ditë mori publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 15.03.2024 këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A. R., nga i ati A. dhe nëna A., mbiemri i vajzërisë së nënës D., i lindur më datë, me vendbanim në fshatin M., Komuna e Podujevë, me numër personal të identifikimit:.... ka të kryer shkollën e mesme, profesioni trajner, i pa martuar baba i dy fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar–Kosovar Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

S e p s e :

Me dt.29/03/2022, rreth orës 10:35, në fshatin B., Komuna Podujevë, i pandehuri A. R., me dije e ka përdorur patentë shoferin me nr. DL....., si të vërtet edhe pse e ka ditur se nuk është tillë, ashtu që kur e ndalon policia të njëjtit ja prezanton patentë shoferin, e për të cilin pas verifikimit është vërtetuar se patentë shoferi është i falsifikuar.

- më këtë ka kryer veprën penale Falsifikimi i dokumentit nga neni 390 par.1 të KPRK-së

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 2, 4, 7, 8, 9, 10, 17, 38, 39, 40, 43, 69, 70, dhe nenit 390 të KPRK-së si dhe në bazë të neneve 242, 269, 364, 365, 368, 369, 449, 462 të KPPRK-së, e:

G J Y K O N

- I. Të akuzuarin e gjykon me dënim me gjobë në shumë prej 250.00€ (dyqind e pesëdhjetë/Euro), të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.
- II. Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë pas afatit prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgimi, ashtu që për çdo 20€ (njëzet euro), të papaguara do t'i llogaritet 1(një) ditë burg.
- III. Konform nenit 269 të KPPRK-së, të akuzuarit i konfiskohet: patentë shoferi me nr. DL....., si mjet i kryerjes së veprës penale.
- IV. Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, në emër të shpenzimeve paushalle të paguaj shumën prej 20.00€ (njëzet/Euro), si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajnë shumën prej 20.00€ (njëzet/Euro), brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën, PP/II.nr.3693/2022 të dt.22.02.2024, kundër të akuzuarit: A. R., për shkak të veprës penale Falsifikimi i dokumentit nga neni 390 par. 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 13.03.2024, në të cilën prezantuan prokurori i shtetit Menduhi Kastrati nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, si dhe i akuzuari.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit i akuzuari në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi: E pranoj fajësinë është e vërtet si në aktakuzë, ky rast nuk do të përsëritet më asnjëherë, jam baba i dy fëmijëve, lus gjykatën që të më shqiptoj një dënim sa më të lehtë.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari deklaroi: E pranoj pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehurit, ngase gjen mbështetje në shkresat e lëndës dhe mbështetje në dispozitat ligjore të KPPRK-së, i propozoj gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë, të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, gjykatës i propozoj po ashtu patentë shoferin ta konfiskoj.

Gjykata pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 242 par.1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 242 par.6 të KPPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarve, kështu që i njëjtit penalisht është përgjegjës.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Falsifikimi i dokumentit nga neni 390 par. 1 KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penalo-juridik është përgjegjës, për çka të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 69 dhe 70 dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila iu vihet në barrë, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata nuk gjeti. Andaj gjykata duke vlerësuar këto rrethana ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, të bëjë kompensimin e dëmit të shkaktuar nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit të parapara me nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi zëvendësimin e dënimit me gjobë në dënim me burgim është marrë në kuptim të nenit 43 par.3 të KPRK-së.

Vendimi konfiskimin e patentë shoferit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 269 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2 nën par. 2.6 lidhur me nenin 452 par. 1 të KPRK-së dhe vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 36 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË,
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal
P.nr.65/2024 me dt.15.03.2024

G j y q t a r i

Minir Hoti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.